



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 42, datë 29.04.2020

**“PËR  
MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT  
TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 44, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 51, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit plotësues nr.1 datë 17.01.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit 2019”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2019, sipas pasqyrave bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

TONI GOGU

